



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN290620260010

Tiranë, më 15.07.2026

Komisioni 79

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi Juridik: “Eralb Invest 2” Sh.p.k

Nr. NIPT-i: M21823010B

Adresa e selisë: Tirane Rruga Dervish Hima, Godina Ambasador 3, Kati 17, Ap. 131, Tirane

Personi përgjegjës: Pëllumb Kallaba

Për të zhvilluar projektin: **“PARKU EOLIK TROPOJE ”.**

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure. Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike

Vendndodhja: Bashkia Tropojë, Qarku Kukës

Të dhëna teknike:

Fuqia e instaluar: 366 MW

Numri i turbinave: 60 cope

Fuqia per turbine: 6.1 MW

Prodhimi neto P50: 713.5 GWh/vit

Oret e plota vjetor: e 2481 Ore/vit

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

Ky subjekt është pajisur me Njoftim për fillim procedure në komisionin Nr.12, datë 03.02.2025 sipas mendimeve të mëposhtëme.

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet si më poshtë vijon:

Bazuar në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të përcjellë për mendim, për veprimtarinë “PARKU EOLIK TROPOJE”, me vendodhje në Tropojë, me numër aplikimi AN120520260120, sa i përket fushës së cilësisë së ajrit në mjedis, menaxhimit të kimikateve, sidhe asaj të ndryshimeve klimatike, Drejtoria e Klimës shprehet parimisht dakord. Prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar energjinë e erës është një nga mënyrat më miqësore me mjedisin, me pothuasje aspak ndikim në mjedis gjatë fazës së gjenerimit të energjisë. Bazuar në VKM-në nr. 581, datë 06.10.2021 “Për miratimin e Kontributit Kombëtar të Përcaktuar”, politikat e Qeverisë Shqiptare nxisin prodhimin e energjisë së rinovueshme, të cilat ndikojnë pozitivisht në arritjen e qëllimit kombëtar për uljen e emetimeve me 20.9% deri në vitin 2030.

Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese shprehet : Aplikuesi, i cili në aplikimin AN120520260120, datë 12.05.2026, kërkon të pajiset me VNM praprake, duhet të përmbushen detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve, si më poshtë vijon:

1. Të zbatohet Ligji nr. 57, date 16.10.2025 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
2. Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
3. Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
4. Të zbatohen kërkesat e VKM nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
5. Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.
6. Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.
7. Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 68, të ligjit nr. 57, date 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

8. Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.177, date 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprintarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Drejtoria e Biodiversitetit për këtë aktivitet shprehen:

Bazuar në dokumentacionin shtese, raportet e ri-plotësuara lidhur me kërkesat tona, vlerësojmë se:

- ndërtimi i projektit dhe aktiviteti gjatë kohës së zhvillimit të tij duhet të ketë parasysh parashtimet ligjore të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, të ndryshuar, ligjit 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, ligjit nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar dhe ligjit nr.10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”, i ndryshuar;
- për sipërfaqet që forma e përdorimit do të ndryshojë, duhen ndjekur procedurat sipas VKM nr.888, datë 27.12.2022 dhe VKM nr.1374, datë 10.10.2008, i ndryshuar si dhe parashtimet konkrete (sipas planit të rehabilitimit në këtë aplikim) për rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve;
- në kontratën e qirasë me bashkinë Tropojë përveç sipërfaqet e kërkuara që nuk ndryshojnë formën (kategorinë e përdorimit) të jenë të përfshira edhe rrugët e aksesit për projektin;
- megjithëse nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki janë verifikuar sipërfaqet ku do vendosen bazamentet dhe elementet e projektit (shtyllat e parkut fotovoltai),

Drejtoria e Biodiversitetit sugjeron mundësimin e hartimit të planeve të mbarështimit për pyjet e kullotat për ekonomitë pyjore “Lugina e Kolgecaje”, “Lugina e Tropojës”, “Berishë-Bytyç” dhe “Stoberdë”, përpara marrjes së lejes së ndërtimit;

- inertet dhe materiali që rezultojnë nga punimet të hidhet (depozitohet) në lanfillin e bashkisë (sipas shkresës nr.3125/1, datë 10.6.2026) në shtrimin e rregullimin e rrugëve dhe vende me formë përdorimi shkëmbore/inproduktive dhe karriera të braktisura apo që kanë mbaruar punimet dhe nuk është kryer rehabilitimi;
- lidhur me rehabilitimin e sipërfaqeve e të gjithë elementeve të projektit, duhet bashkëpunuar me strukturën përgjegjëse për pyjet në bashki për zgjedhjen e llojeve dhe mënyrën e rryllëzimit apo pyllëzimit, si dhe duke patur parasysh llojet autoktone

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se: Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Parku Eolik, me kapacitet 366 MW”, Vicol, Tropojë, Qarku Kukës, me zhvillues “Eralb Invest 2” dhe aplikues “GR Albania”, me nr. Aplikimi AN080520260161, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet se: Referuar gjurmës së zonës që do të zhvillohet parku eolik, që rezultojnë prej koordinatave të dhëna në dokumentin “Raporti Teknik” të paraqitur nga ju, të dhënave për trupat ujorë sipas shtresës Hidrografia në Gjeoportalin ASIG, rezultojnë se projekti i zhvillimit nuk është në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore.

Ministria e Infrastukture dhe Energjisë shprehet se: Aprovim automatik ne hehtje !

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet: ARM-Shkodër,Lezhë,Kukës sjellë ne vëmendje se perderisa ky projekt prek disa fshatra, perkatësisht fshatrat Vicol, Vlad, Degë, Luzhe, Mashe, Mejdan, Çorre-Velaj, Denaliaj, Rac dhe Zherkë, sugjerojmë që të bëhet një konsultim me publikun në lidhje me këtë projekt.

-Pas kryerjes se degjeses me publikun, informacioni ne lidhje me degjese e kryer eshte derguar ne AKM nepermjet sistemit sim.akm.gov.al. Ne keto kushte ARM Shkoder-Lezhe-Kukes shpreh dakortësinë ne lidhje me zhvillimin e ketij projektit.

Bashkia Tropojë shprehet: Bashkia Tropojë, pasi shqyrtoi kerkesen tuaj dhe dokumentacionin perkatës, si dhe nëreferencë të Vëndimit të Këshillit Bashkiak nr.36, datë 28.03.2024, e vlereson projektin në fjalë si një nismë me interes për zhvillimin energjetik dhe ekonomik të territorit duke zbatuar dispozitat ligjore ne vazhdimi.

Në këtë kuadër, Bashkia Tropojë shpreh miratimin në parim për zhvillimin e projektit "Parku Eolik Tropojë".

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Degjesa me publikun, ne bashkepunim me zhvilluesin dhe me NJQV, ishte vendosur të bëhej me dt 13.07 .2026, ne orën 12:00 Takimi u zhvillua me dt 13.07 .2026, ne oren 12:00. Ky takim zgjati afërsisht 1 ore e 30 minuta. Vendi ku u zhvillua konsultimi me publikun ishte ne fshatin Pac, Nj. Ad. Bytyç, Bashkia Tropoje.

Pjesëmarrës në takim Përfaqësues të kompanisë zhvilluese të projektit ERALB INVEST 2, Përfaqësues të studios mjedisore GR Albania, Administratori i Nj. Ad. Tropojë, Administratori i Nj. Ad. Fierzë, Ad. Nj. Bytyç, Kryetarët e fshatrave Sopot, Luzhë, Mash, Bytyç, përfaqësues të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë—Shkodër—Kukës, dy përfaqësues të një subjekti si palë e interesuar që ushtron aktivitet të ngjashëm në zonë dhe banorë të komuniteteve ku zhvillohet ky projekt.

-Prezantimi dhe shpjegimet për pyetjet apo shqetësimet e banorëve ishte i qartë dhe u mirëprit në komentë pozitive nga palët e interesuara. Banorët shprehen interesin pozitiv për zhvillimin e kesaj veprimtarie duke vlerësuar kontributin e saj

-Publiku gjatë dëgjësës u informua gjerësisht për çështjet teknike, mjedisore dhe sociale të lidhura me zhvillimin e veprimtarisë, se mësipërcituar.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 79, datë 15.07.2026, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.15, datë 20.01.2026, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka pajisur shoqërinë “Eralb Invest 2” Sh.p.k me Miratim Paraprak Nr. 214/1 Prot., datë 09.01.2026 "Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike me kapacitet të instaluar 603.9 MW, dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni me vendndodhje Bashkia Tropojë, Qarku Kukës
- Njoftimin për fillim procedure në komisionin Nr.65, datë 12.06.2026.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3 Ky vendim është i vlefshëm vetëm për aktivitetin e përkohshëm sipas titullit të instalimit. Ndalohet kategorikisht hyrja dhe qëndrimi i mejeve të tjera apo kryerja e veprimtarive jashtë kërkesave të parashikuara në aplikim.
- 4.4 Masa e dheut të gjeneruar nga operacionet e gërmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 4.5 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj.);4.6 Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.6 Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuara
- 4.7 Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.10 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.11 Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 4.12 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.13 Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 4.14 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacione DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga kyaksident.
- 4.15 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Deklaratë.
- 4.16 Të kryhet mirëmbajtja në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur një imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 4.17 Të evitohet turbullimi i ujit që ndikon drejtëpërdrejtë në ciklet biologjike të mjedisit ujor.
- 4.18 Në rast se gjatë fazes së instalimit, projekti ka nevojë për vepra të tjera në shërbim të tij (venddepozitime, rrugë etj.), subjekti duhet t’i nënshtrohet procedurave të VNM-së sipas legjislacionit në fuqi.

- 4.19 Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.20 Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.21 Në rast se do të mbyllet aktiviteti, të rehabilitohet mjedisi në përdorim, në bashkëpunim me pushtetin vendor.
- 4.22 Në përfundim të instalimit sipas periudhës së përcaktuar në raportin Teknik 6-mujore të vlerësohet gjendja mjedisore.
- 4.23 Në përfundim të afatit 24 mujor të funksionimit të bëhet një raport mbi gjendjen e mjedist për ndotjen e mundshme në mjedisin ujor, tokësor dhe në ajër.
- 4.24 Një nga masat kryesore zbutëse që mund të përdoret për të mbrojtur zogjtë nga përplasja me linjat ajrore është përdorimi i shënjesve të linjës (devijuesit) për të rritur shikueshmërinë e tyre.
- 4.25 Të gjitha dherat e gjeneruara gjatë fazës së germimit si dhe vegetacioni e humusi pas pastrimit të kanalit të kullimit do të duhet të menaxhohen me teknikat më të mira të disponueshme nga subjekti zhvillues.
- 4.26 Të gjitha veprat hidrike si hidrovore, ura, argjinatura do të duhet të ruhen me prioritet sipas pritshmërisë së qëllimit final të projektit.
- 4.27 Të punohet me orare të reduktuara gjatë shtrimit të linjës së transmetimit të tensionit të lartë në zonat e urbanizuara për shkak të nivelit të zhurmave dhe shtimit të trafikut.
- 4.28 Subjekti zhvillues gjatë fazës së punimeve do të duhet të kujdeset për vendosjen dhe respektimin e sinjalistikave të duhura rrugore sipas legjislacionit vendas, në aspektin e sigurisë së lëvizjes së njerëzve, mjeteve motorrike si kamionë, autovetura mjete agrobujqësore.
- 4.29 Çdo objekt banimi/shërbimi dhe pronat ku kalon linja e interkonjeksionit do të duhet të shpronësohen sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.30 Nëse gjatë fazës së kryerjes së punimeve do të zbulohen gjetje arkeologjike do të duhet të njoftohen menjëherë autoritetet përgjegjëse dhe të ndërpriten punimet.
- 4.31 Të rehabilitohet sheshi i zonës së zhvillimit të projektit në përfundim të jetëgjatësisë së tij.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	15.01.2027	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	15.01.2027	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	15.01.2027	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	15.01.2027	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	15.01.2027	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	15.01.2027	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për Deklaratë Mjedisore për projektin e propozuar është e vlefshme për atë kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

MARJETA PËRLALA

MINISTRI

SOFJAN JAUPAJ

Aneksi 1. Harta me Koordinatat




Tabela 1: Koordinatat e zonës së studimit mjedisor

KOORDINATAT E ZONES SE STUDIMIT MJEDISOR						
No	WGS84		KRGJSH		GAUSS KRUGER ZONE 4	
	X_EAST	Y_NORTH	X_NORTH	Y_NORTH	X_EAST	Y_NORTH
1	20.24647	42.32383	520316.3728	4687636.182	4438017.866	4688013.878
2	20.27526	42.26116	522712.0216	4680682.131	4440331.789	4681031.835
3	20.13829	42.24381	511413.5926	4678727.494	4429010.552	4679209.823
4	20.13357	42.2723	511019.0721	4681891.494	4428653.17	4682378.455
5	20.13015	42.30327	510731.6757	4685331.171	4428406.171	4685821.509
6	20.08824	42.3338	507272.4194	4688717.995	4424986.7	4689248.999
7	20.0927	42.34379	507638.7871	4689828.074	4425366.121	4690354.779
8	20.0977	42.35188	508049.7715	4690727.173	4425787.679	4691249.051
9	20.11217	42.36797	509239.6371	4692515.926	4426998.588	4693023.818
10	20.13978	42.38445	511510.9109	4694349.904	4429291.44	4694831.079
11	20.16626	42.39863	513688.4632	4695928.958	4431487.567	4696384.502
12	20.19518	42.4073	516067.2835	4696897.096	4433877.763	4697324.633
13	20.22273	42.41287	518333.5876	4697521.397	4436151.387	4697922.248

Tabela 2: Koordinatat e turbinave

WTG Number	WTG84 UTM34N		KRGJSH	
	X [m]	Y [m]	E [m]	N [m]
T1	431175.390	4682772.850	513616.197	4684322.324
T2	430889.000	4683281.000	513323.758	4684827.249
T3	431411.663	4682189.767	513859.386	4683741.856
T4	433289.000	4687481.000	515675.054	4689056.622
T5	437534.000	4682546.000	519979.263	4684170.117
T6	437258.053	4683651.360	519690.249	4685272.553
T7	437430.000	4683168.000	519867.925	4684791.075
T8	432012.000	4682073.000	514461.260	4683632.110
T9	438019.000	4682324.000	520467.011	4683953.752
T10	437224.000	4681638.000	519679.841	4683258.214
T11	432399.740	4681700.170	514853.488	4683263.731
T12	429877.000	4683763.000	512305.817	4685297.489
T14	432939.850	4681128.230	515400.466	4682697.977
T15	437355.000	4681110.000	519817.081	4682731.601
T16	436887.980	4684004.060	519315.925	4685621.005
T17	433196.000	4680756.000	515661.060	4682328.651
T18	429654.000	4680040.000	512126.492	4681570.856
T19	438494.000	4682076.000	520945.062	4683711.260
T20	433852.000	4687210.000	516241.398	4688792.167
T21	429676.306	4681730.020	512128.954	4683261.598
T23	430047.000	4679090.000	512530.754	4680625.212
T24	430389.000	4678680.000	512877.662	4680219.115
T25	435489.000	4687381.000	517876.849	4688982.463
T26	433488.000	4680327.000	515958.180	4681902.961
T27	436835.000	4681967.000	519286.864	4683582.739
T28	429955.000	4689999.000	512310.519	4691536.105
T29	436195.050	4683905.000	518623.961	4685513.774
T30	437125.000	4680224.000	519597.421	4681842.645
T31	429744.000	4681156.000	512203.409	4682688.216
T32	429441.000	4680503.000	511907.997	4682031.480
T33	429495.410	4678252.820	511988.843	4679781.327
T34	430381.280	4683509.540	512813.213	4685049.885
T35	430827.000	4678449.000	513318.494	4679993.194
T36	430999.000	4677969.000	513496.176	4679515.081
T37	429777.000	4677879.000	512274.898	4679410.711
T39	435680.200	4684454.990	518102.500	4686057.870
T40	437768.000	4680732.000	520234.639	4682358.343
T41	438038.000	4680309.000	520509.685	4681938.392
T42	438390.000	4679935.000	520866.180	4681568.418
T43	438915.000	4679555.000	521395.794	4681194.473

T44	439651.516	4679349.808	522134.935	4680997.869
T46	436445.000	4688749.000	518817.034	4690362.095
T48	432173.000	4690062.000	514528.387	4691625.215
T49	429684.810	4690443.753	512035.023	4691977.801
T50	429545.000	4690940.000	511889.337	4692472.537
T56	432106.000	4689441.000	514468.674	4691003.254
T57	432359.000	4688992.000	514727.025	4690557.106
T58	430697.000	4689331.000	513060.580	4690876.651
T59	430284.450	4689638.600	512644.299	4691179.482
T60	432583.000	4688568.000	514956.074	4690135.623
T62	432141.000	4690945.000	514485.990	4692508.083
T63	429204.000	4683860.000	511631.495	4685386.607
T65	432086.000	4684054.000	514512.005	4685614.528
T66	431649.000	4684572.000	514068.796	4686127.535
T67	432291.940	4683622.410	514723.073	4685185.238
T68	431583.000	4683430.000	514016.198	4684984.444
T75	434540.000	4687410.000	516927.240	4689000.313
T64	433372.000	4679158.000	515855.875	4680732.272
T76	429256.000	4682374.000	511700.969	4683900.815
T77	429094.000	4683014.000	511531.406	4684539.085

